



Planuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	27-06-2022	2	viti god year
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHUK	3753/2022		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.473/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.473/2022 të datës 24.05.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ne adresë banimi \_\_\_\_\_

kundër organit të Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.473/2022 e datës 24.05.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Prot.256 i datës 13.05.2022, i nxjerrë nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ ka qenë i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, sipas Akt emërimit me numër Nr.Prot.02/816/09 të datës 14.12.2012, në pozitën "Inspektor tatimor" në Zyrën Regjionale të ATK-së në Prizren.

Me datën 15.04.2020, Drejtori i Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër 195, sipas të cilit ankuesi është pezulluar nga puna me 50% te pagës, pas pranimit të njoftimit zyrtar nga Drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit DPP-Prishtinë mbi arrestimin e ankuesit, nën dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer

veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i KPK-së dhe “Marrje e ryshfetit” nga neni 421 i KPK-së.

Me datën 17.05.2021, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka nxjerrë Aktgjykimin PKR.nr.182/20, sipas të cilit ankuesin e ka gjetur fajtor dhe e ka dënuar në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve burgim, si dhe dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e dyqind (1200) euro, për veprën penale “Marrje e ryshfetit” nga neni 428 par.1 të KPRK-së. Pas ankesës së ankuesit në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kjo e fundit me datën 20.10.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin PAKR.nr.243/21 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe e ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda.

Ndërsa me datën 13.05.2022, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerre Vendimin Nr.Prot.256, sipas të cilit ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbimin civil pas pranimit të aktgjyimit nga Gjykata e Apelit të Kosovës me datën 10.05.2022, kur i njëjti ishte bërë i plotfuqishëm.

Ankuesi i pakënaqur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me datën 24.05.2022 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2988/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datën 06.06.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës. Administrata Tatimore e Kosovës me datën 10.06.2022, ka përcjell shkresat lidhur me dokumentacionin e bashkangjitur të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot: 2988/2022 të datës 24.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.Prot.256 të datës 13.05.2022 nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.06.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 10.06.2022 nga Administrata Tatimore të Kosovës me provat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimin e ankuesit me numër 02/816/09 të datës 14.12.2012; Vendimin me numër 195 të datës 15.04.2020 nga Drejtori i Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës; Formularin e datës 15.04.2020 për lajmërimin e pezullimit parandalues; Aktgjykimin PKR.nr.182/20 të datës 17.05.2021 të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda; Aktgjykimin PAKR.nr.243/21 të datës 20.10.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se sipas Vendimit 195 të datës 15.04.2022, i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi është pezulluar nga puna me 50% të pagës, pas pranimit të njoftimit zyrtar nga Drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit DPP-Prishtinë mbi arrestimin e ankuesit nën dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer



veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i KPK-së dhe “Marrje e ryshfetit” nga neni 421 i KPK-së. Me këtë rast Kolegji vlerëson se Drejtori i Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së vendimit për pezullimin e ankuesit me 50% të pagës, ka vepruar në pajtim me nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, sipas të cilit është përcaktuar që: *“1. Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se me datën 17.05.2021, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka nxjerrë Aktgjykimin PKR.nr.182/20, sipas të cilit ankuesin e ka gjetur fajtor dhe e ka dënuar në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve burgim, si dhe dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e dyqind (1200) euro, për veprën penale “Marrje e ryshfetit” nga neni 428 par.1 të KPRK-së. Pas ankesës së ankuesit në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kjo e fundit me datën 20.10.2021, ka nxjerrë Aktgjykimin PAKR.nr.243/21 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe e ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda. Andaj pas vlerësimit dhe rrethanave të cekura si më lartë, Kolegji ka konstatuar se Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Prot.256 të datës 13.05.2022, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pas pranimit të Aktgjykimit PAKR.nr.243/21 të datës 20.10.2021, nga Gjykata e Apelit të Kosovës me datën 10.05.2022, ku i njëjti ishte bërë i plotfuqishëm, ka vepruar në pajtim me nenin 60 paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, në të cilin përcaktohet se: *“1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër”*. Po ashtu, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës për ankuesin, ka vepruar gjithashtu në pajtim edhe me nenin 32 paragrafin 3, ku shprehimisht përcaktohet se: *“3. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji”*, andaj Kolegji vlerëson se me këtë rast organi i punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, mbi këtë bazë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit ka nxjerrë vendim të drejtë dhe ligjor.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.473/2022, datë 27.06.2022.

Sabile Avdyli

  
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- ❖ Arkivoit të KPMSHCK-së

